



UK Health
Security
Agency

NHS

Si ta mbroni foshnjën tuaj nga **RSV**

Një udhëzues për vaksinën
e virusit sincicial të
frymëmarrjes (RSV) për
gratë shtatzëna



Nga shtatori 2024, gratë shtatzëna mund të kenë një vaksinë falas në çdo shtatzëni, për të mbrojtur foshnjat e tyre kundër virusit sincicial të frymëmarrjes (RSV).

Pse duhet t'i mbrojmë foshnjat nga RSV?

Virusi sincicial i frymëmarrjes ose RSV është një virus i zakonshëm që mund të shkaktojë një infeksion të mushkërive të quajtur bronkiolit. Tek foshnjat e vogla kjo gjendje mund të vështirësojë frymëmarrjen dhe ushqimin. Shumica e rasteve mund të menaxhohen në shtëpi, por rreth 20,000 foshnja shtohen në spital me bronkiolit çdo vit në Angli. Foshnjat me bronkiolit të rëndë mund të kenë nevojë për kujdes intensiv dhe infeksioni mund të jetë fatal. RSV ka më shumë të ngjarë të jetë serioz tek foshnjat shumë të vogla, ato të lindura para kohe dhe ato me kushte që prekin zemrën, frymëmarrjen ose sistemin imunitar.

Infeksionet RSV mund të ndodhin gjatë gjithë vitit, por rastet arrijnë kulmin çdo dimër.

Si përhapet RSV?

RSV është shumë infektive dhe përhapet lehtësisht, veçanërisht tek fëmijët, përmes kollitjes dhe teshtitjes. Edhe me masa të thjeshta si larja e duarve dhe mbulimi i gojës dhe hundës kur teshtitni, është e vështirë të shmangni përhapjen e infeksionit brenda familjes. Mënyra më e mirë për të mbrojtur fëmijën tuaj kundër infeksionit RSV është që ju të bëni vaksinën gjatë shtatzënisë.

Sa efektive është vakcina RSV?

Vaksina rrit sistemin tuaj imunitar për të prodhuar më shumë antitrupa kundër virusit. Këto antitrupa më pas kalojnë nëpër placentë për të ndihmuar në mbrojtjen e foshnjës tuaj që nga dita e lindjes. Vaksinimi kundër RSV ul rrezikun e bronkiolitit të rëndë me 70% në 6 muajt e parë të jetës.

Pas kësaj moshe foshnja juaj është në rrezik shumë më të ulët të RSV-së së rëndë.

Fëmijët më të rritur dhe të rriturit gjithashtu mund ta marrin infeksionin RSV, por sëmundja është më serioze për foshnjat e vogla dhe njerëzit e moshës 75 vjeç e lart.

Kur duhet të vaksinohem?

Duhet t'ju ofrohet rreth kohës së takimit tuaj 28 javë para lindjes. Nëse nuk keni dëgjuar deri në këtë fazë, kontaktoni shërbimin tuaj të maternitetit ose klinikën e mjekut të përgjithshëm për të caktuar një takim. Marrja e vaksinës në javën e 28-të ose brenda disa javësh pas kësaj do t'ju ndihmojë të krijoni një nivel të mirë të antitropave për t'ia kaluar fëmijës tuaj përpara lindjes. Kjo do t'i japë fëmijës tuaj mbrojtjen më të mirë, duke përfshirë nëse ai lind herët.

Vaksinën mund ta bëni edhe më vonë gjatë shtatzënisë, por mund të jetë më pak efektive. Nëse nuk ka qenë e mundur ta bënit vaksinën tuaj më herët, ajo mund të jepet deri sa të lindni foshnjën. Nëse e keni atë shumë vonë në shtatzëni, mund t'ju mbrojë nga infeksioni dhe të zvogëlojë rrezikun e përhapjes së infeksionit tek fëmija juaj i porsalindur.

Si jepet dhe cilat janë efektet anësore?

Vaksina është një injeksion i vetëm në pjesën e sipërme të krahut.

Efektet anësore janë zakonisht të lehta. Këto përfshijnë:

- dhimbje koke
- dhimbje muskulore
- dhimbje, skuqje ose ënjtje në vendin e injektimit

A është vakcina RSV gjatë shtatzënisë e sigurt për foshnjën time?

Vaksina është studiuar në provat klinike të pothuajse 4000 grave dhe u është dhënë mijëra grave në programet kombëtare. Monitorimi në SHBA, ku u është dhënë mbi 100 mijë grave, ka treguar një profil të mirë sigurie. Në provën klinike kryesore, në muajin pas vaksinimit, kishte pak më shumë foshnja të lindura para kohe në grupin e vaksinës (2.1%) sesa grupi që nuk e kishte vaksinën (1.9%). Ky ndryshim ka shumë të ngjarë të jetë për shkak të rastësisë. Vaksina është miratuar nga rregullatorët e ilaçeve në Mbretërinë e Bashkuar, Evropë dhe SHBA në bazë të mbrojtjes, cilësisë dhe sigurisë.

A nënkupton bërja e vaksinës që foshnja im nuk do e kapë RSV-në?

Është treguar se vakcina redukton mundësinë që fëmija juaj të vuajë nga sëmundja e rëndë e RSV-së. Ashtu si të gjitha ilaçet, asnjë vaksinë nuk është plotësisht efektive dhe disa foshnje mund të kenë ende infeksion RSV, pavarësisht se nënat e tyre e kanë bërë vaksinën. Por për shumicën e foshnjave të lindura nga nëna të vaksinuara, çdo infeksion RSV duhet të jetë më pak i rëndë.

Ju mund të lexoni fletëpalosjen e informacionit të pacientit për vaksinën RSV të quajtur Abrysvo këtu: www.medicines.org.uk/emc/product/15309/pil

Po sikur fëmija im të jetë në rrezik më të lartë?

Disa foshnjave me rrezik më të lartë të RSV-së, të tilla si ato që janë shumë të parakohshme, ata me sëmundje të rënda të zemrës ose ata me imunitet të dobësuar mund t'u ofrohet gjithashtu një injeksion antitripash. Ky injeksion do të sigurojë mbrojtje shtesë mbi çdo antitrip që mund të marrin nga nëna e tyre.

A duhet të bëj vaksinën RSV në çdo shtatzëni?

Po, ju duhet ta keni atë në çdo shtatzëni për t'i dhënë foshnjës tuaj të re mbrojtjen më të mirë.

A mund t'i bëj vaksinat e tjera të nënës në të njëjtën kohë me vaksinën time RSV?

Është e rëndësishme që vaksinat tuaja të bëhen në kohën e duhur gjatë shtatzënisë:

- vakcina e kollës së mirë zakonisht jepet më herët në shtatzëni (rreth kohës së skanimit të mesit të shtatzënisë, zakonisht 20 javëshe)
- ju duhet të bëni vaksinën tuaj RSV sapo të jeni 28 javëshe shtatzënë
- vakcina kundër gripit mund të jepet në çdo fazë të shtatzënisë. Duhet ta bëni sa më shpejt që të jetë e disponueshme për ju

Kur të thirrreni për vaksinën tuaj kundër RSV-së, nëse nuk i keni bërë ende vaksinat kundër kollës ose gripit, atëherë duhet t'i bëni ato në të njëjtën kohë.

Ku mund të marr më shumë informacion?

Ju mund të bisedoni me maminë ose klinikën e mjekut të përgjithshëm dhe mund ta lexoni këtë fletëpalosje në internet këtu:

www.gov.uk/government/publications/respiratory-syncytial-virus-rsv-maternal-vaccination

www.nhs.uk/pregnancy/keeping-well/vaccinations

Për informacion të mëtejshëm mbi vaksinat që do t'ju ofrohen kur jeni shtatzënë e gjeni këtu:

www.gov.uk/government/publications/pregnancy-how-to-help-protect-you-and-your-baby

A mund të ketë foshnja ime bronkiolit RSV?

Simptomat e bronkiolitit RSV mund të përfshijnë:

- hundë me rrjedhje ose të bllokuar
- frymëmarrje të vështirë, të shpejtë ose e zhurmshme (gulçim)
- vështirësi në të ushqyer
- kollë
- ethe
- e/i paqëndrueshëm ose e/i vështirë për t'u ngushëlluar
- lodhje ose mungesë energjie

RSV-ja gjithashtu mund të shkaktojë gjendje të tjera tek fëmijët e vegjël, si kollë e lehur (kup) dhe një infeksion të dhimbshëm brenda veshit (otitis media).



Mund të raportoni efekte anësore të dyshuara në faqen e internetit të Kartës së Verdhë (Yellow

Card) ose duke telefonuar në linjën telefonike falas 0800 731 6789 (9 paradite deri në 5 pasdite nga e hëna në të premte) ose duke shkarkuar aplikacionin Yellow Card.

www.mhra.gov.uk/yellowcard

Kërkoni një takim urgjent të mjekut të përgjithshëm ose telefononi 111 nëse:

- fëmija juaj është ftohur dhe po përkeqësohet
- fëmija juaj po ushqehet ose ha shumë më pak se normalja
- fëmija juaj ka pasur një pelenë të thatë për 12 orë ose më shumë, ose tregon shenja të tjera dehidrimi
- fëmija juaj është nën 3 muaj dhe ka një temperaturë prej 38°C, ose është më i madhvetër se 3 muaj dhe ka një temperaturë prej 39°C ose më të lartë

Telefoni 999 ose shkoni tek Urgjenca nëse:

Foshnja juaj duket shumë e sëmurë, besojini gjykimit tuaj. Ju duhet të veproni nëse:

- foshnja juaj ka vështirësi në frymëmarrje – ju mund të vëreni zhurma gërvishtëse ose gjoksin dhe murin e barkut të tij duke u thithur në mes ose gati nën brinjë
- ka pauza kur fëmija juaj merr frymë
- lëkura, gjuha ose buzët e fëmijës tuaj janë blu
- fëmija juaj bën lëvizje të pakontrolluara dhe nuk do të zgjohet ose të qëndrojë zgjuar

